



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

Nr _____ Prot

Vlorë, më _____. ____ 2026

**PROCES VERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOS NDARJEN E PROCEDURËS
SË PROKURIMIT NË LOTE**

Objekti : Blerje kamione per Ndermarrjen e Pastrimit per vitin 2026

Fondi limit : 45,400,000(Dyzetë e pesë milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Leke

Fondi Limit : 484,939 (katërqind e tetëdhjetë e katërmijë e nentëqind e tridhjetë e nente) Euro

Kodi CPV: 42415200-0 - Kamionë pune, 34136200-1 - Kamionçina, 34134200-7 - Kamionë vetëshkarkues,

Tipi i Proedurës: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF;94240-07-22-2026

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 90 dite

Duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor sqarojme se:

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.
Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Në bazë të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar AK *nuk është i detyruar ta ndajë në lote sipas përcaktimieve të nenit 39 pika 1*, por duhet të justifikojë vendimin e vet. Kjo procedurë nuk ndahet në lote për këto arsye:

Objekti : Blerje kamione për Ndermarrjen e Pastrimit për vitin 2026

Fondi limit : 45,400,000 (Dyzetë e pesë milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Leke

Fondi Limit : 484,939 (katërqind e tetëdhjetë e katërmijë e nentëqind e tridhjetë e nente) Euro

Kodi CPV: 42415200-0 - Kamionë pune, 34136200-1 - Kamionçina, 34134200-7 - Kamionë vetëshkarkues,

Tipi i Proedurës: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF;94240-07-22-2026

Kjo procedurë përfshin vetëm një zë në preventiv dhe si e tillë *nuk ka ndarje funksionale ose teknike që të justifikojë ndarjen në lote.*